

5-15R

PYETËSORI PËR VLERËSIMIN E ZHVILLIMIT DHE SJELLJES

Pyetësoni i prindërve

Për prindërit: Ky pyetësor, për fëmijët dhe adoleshentët e moshave 5 deri 17 vjeç, përmban deklarata në lidhje me aftësitë dhe sjelljet e fëmijut tuaj në fusha të ndryshme të zhvillimit. Fëmijët janë individë. Kjo do të thotë që aftësitë dhe sjelljet dallojnë nga një fëmijë në tjetrin, dhe sipas moshës.

Pyetësoni përmban deklarata të cilat në pyetësor pasohen nga kutitë e shënuara **Nuk aplikohet - Deri ne nje masë aplikohet - Aplikohet**. Shëno në kutinë e cila përmban deklaratën që ju mendoni se korrespondon më së miri me funksionimin e fëmijës në situata të përditshme, krahasuar me fëmijët e moshës së tij/saj. Të keni në mendje funksionimin e tashëm të fëmijës, p.sh. brenda 6 muajve të fundit. Për të marrë pasqyrën më të saktë të funksionimit të fëmijës tuaj, është e rëndësishme të plotësoni të tërë pyetësonin.

Ju do të pyeteni nëse funksionimi i fëmijës në fusha të ndryshme çon në probleme të jetës e përditshme. Ju lutem merrni parasysh nëse këto probleme ndikojnë fëmijët ose të tjerët në shtëpi, shkollë dhe shoqëri. Këto pyetje pasohen nga katër opsione: **Jo - Pak - Goxha - Shume**.

Për profesionistet që përdorin këtë pyetësor: Pyetësoni synon të sqaroj pikëpamjet e prindërve ndaj pikave të forta dhe të dobëta në shumë fusha zhvillimore. Nuk ka për qëllim të shërbej si një bazë e vetme për vendime diagnostikuese. Përdorimi i këtij pyetësori kërkon njohuri rreth zhvillimit tipik dhe jo-tipik të fëmijëve si dhe njohuri bazike në psikometri. Udhëzimet për përdorimin profesional, administrimin dhe pikëzimin gjenden në **MANUAL**.

Një botim i këtij pyetësori për mësimdhënës është gjithashtu në dispozicion në verzionin original, por jo në gjuhën shqipe.

Përkthimi dhe përshtatja e këtij pyetësori në gjuhën shqipe është realizuar nga: Arian Musliu, Dardana Fetahu, Diar Hajrizi, Fatime Rrahmani, Shkurtë Bajgora, Vlerë Hyseni, dhe Vlora Jashari.

Reference for this questionnaire: Kadesjö, B., Janols, L-O, Korkman, M., Mickelsson, K., Strand, G., Trillingsgaard, A., Lambek, R., Øgrim, G., Bredesen, A. M., & Gillberg, C. (2017). Five-To-Fifteen-Revised (5-15R). Available at www.5-15.org

Copyright ©: (2004): Björn Kadesjö, Göteborg, Lars-Olof Janols, Uppsala, Marit Korkman, Helsingfors, Katarina Mickelsson, Helsingfors, Gerd Strand, Oslo, Anegen Trillingsgaard, Århus, Christopher Gillberg, Göteborg
The Copyright is protected under the Swedish Copyright Act – the Swedish law Act on Copyright in Literary and Artistic Works (1960:729).

Copying for own use is allowed.

Emri i skedarit: 515_sq.pdf
Versioni i skedarit: 2021.p.1.1
Data e skedarit: 2021-08-25

Deklarata e miratimit për të përpunuar informacionet e dhëna në formë elektronike

Qëllimi i pyetësorit 5-15R dhe sistemi i vlerësimit është të vlerësoj funksionimit e fëmijut në fusha të ndryshme në jetën e përditshme.

Përgjigjet do të krahasohen me një grup të madh përgjigjesh për fëmijët e moshës dhe gjinisë së njejtë.

Vlerësimi mund të identifikoj fushat në të cilat funksionimi i fëmijut do të jetë subjekt interesi për vlerësim të mëtejshëm ose intervenim.

Rezultatet nga ky vlerësim asnjëherë nuk përdoren vetë si bazë për konkludime rreth fëmijës ose ambientit të tij.

Informatat e mbledhura do të futën dhe do të ruhen në një databazë pa ndonjë identifikim të fëmijës osë informuesit. Këto të dhëna do të fshihen jo më vonë se 6 muaj pas grumbullimit.

Unë miratoj mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për qëllimin e përshkruar më lartë.

Nënshkrimi:

Data:

Lidhja juaj me fëmijën: Prind Prind strehues/kujdestar

Tjetër:

Emri i fëmijës tuaj:

Data e lindjes së fëmijës:

Aftësitë motorike - aftësitë motorike të mëdha; përdorimi i trupit të vet nga fëmija në aktivitete të ndryshme:

- | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 1. Vështirësi për të fituar aftësi të reja motorike, si të mësuarit se si të ngasë bicikletën, patinat, të notojë, të skiujë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 2. Vështirësi për të hedhur dhe pritur një top | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 3. Vështirësi për të vrapuar shpejtë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 4. Ka vështirësi ose nuk i pëlqen të marrë pjesë në lojëra sportive si futboll, hokej, basketboll | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 5. Probleme në drejtpeshim; për shembull, ka problem të qëndroj në një këmbë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 6. Shpesh “merr në thua” dhe rrëzohet | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 7. Lëvizje të ngathëta ose të çuditshme | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Aftësitë motorike - aftësitë motorike fine; përdorimi i duarve të veta nga fëmija:

- | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 8. Nuk i pëlqen të vizatoj, ka vështirësi të vizatoj figura që përfaqësojnë diçka | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 9. Vështirësi për të manovruar, montuar dhe manipuluar objekte të vogla | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 10. Vështirësi për të hedhur ujin në gotë pa e derdhur | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 11. Shpesh derdh ushqim në rroba ose në tryezën ku hani | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 12. Vështirësi për të përdorur thikë dhe pirun | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 13. Vështirësi në kopsim (përthekim të pullave) ose për lidhur lidhëset e këpucëve | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 14. Vështirësi për të përdorur laps (p.sh. e shtyp shumë, dora dridhet) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 15. Nuk ka zhvilluar dominancë të qartë të dorës, p.sh., nuk është dukshëm as djathtak as majtak | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 16. Shkrimi është i ngadaltë dhe i mundimshëm | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 17. Mbërthim (kapje) i papjekur i lapsit, mban lapsin në një mënyrë të pazakontë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

A ndërhyjnë problemet e funksionit motorik me funksionimin ditor të fëmijës tuaj?

Jo Pak Goxha Shume

Vëmendja dhe përqëndrimi: aftësia e fëmijës të kushtojë vëmendje dhe të përqëndrohet në detyra dhe aktivitete të ndryshme:

- | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 18. Shpesh dështon t'u kushtojë vëmendje detajeve ose bën gabime të pakujdesshme | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 19. Shpesh ka vështirësi të mbajë vëmendjen në detyra ose aktivitete | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 20. Shpesh duket sikur nuk është duke dëgjuar kur i flitet drejtpërdrejt | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 21. Probleme me ndjekjen e udhëzimeve dhe dështon në përfundimin e detyrave që i ipen, për shembull detyrave të shtëpisë, punëve të shtëpisë, ose përgjegjësi të tjera | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 22. Shpesh ka vështirësi me organizimin e detyrave dhe aktiviteteve | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 23. Shpesh shmang, nuk pëlqen ose ngurron të merret me detyrat që kërkojnë përpjekje të qëndrueshme mendore (siç janë detyrat e shtëpisë) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

	Nuk aplikohet	Deri në një masë aplikohet	Aplikohet
24. Shpesh humb gjërat e nevojshme për detyra dhe aktivitete (p.sh., lodrat dhe pajisjet e tjera për shkollë si, lapsat, librat)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
25. Shpesh shpërqendrohet lehtë nga stimuj të jashtëm (p.sh., tinguj të parëndësishëm si njerëzit tjerë duke biseduar, veturat duke vozitur pranë)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
26. Është shpesh harra q/e në aktivitet e përditshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Aktiviteti i tepërt dhe impulsiviteti; tendenca e fëmijës për të qenë tepër aktiv ose impulsiv:

27. Është në lëvizje të vazhdueshme (sillet për qark, rrotullohet, luan me gishta, shkulë gjëra, etj)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
28. Vështirësi për të qëndruar ulur (përpëlitet në ulëse, ngritet dhe lëvizë përreth)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
29. Shpesh vrapon përreth, ose zvarritet së tepërmi në situata në të cilat është e papërshtatshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
30. Vështirësi për të luajtur qetë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
31. Është shpesh “në lëvizje” ose shpesh vepron sikur “drejtohet nga një motor”	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
32. Shpesh flet së tepërmi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
33. Shpesh i thotë përgjigjet përpara se pyetjet të kenë përfunduar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
34. Vështirësi për të pritur në rradhë (për të hyrë në klasë, në lojëra, gjatë shpërndarjes së shujtave etj)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
35. Shpesh ndërpreen ose ndërhyen tek të tjerët (p.sh., ndërpret biseda ose lojëra)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyjnë problemet me vëmendje, përqëndrim, aktiviteti i tepërt ose impulsiviteti me funksionimin ditor të fëmijës?

Jo Pak Goxha Shume

Pasiviteti/Jo-aktiviteti: inaktiviteti i fëmijës ose tendenca për të qenë shumë pasiv

36. Vështirësi për të filluar në detyra/aktivitete	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
37. Vështirësi për të përfunduar një detyrë/aktivitet, nuk i përfundon gjërat si pjesa tjetër e grupit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
38. Shpesh është në “botën e tij”, ose duke ëndërruar me sy hapur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
39. Duket i/e ngadaltë, inert, ose që i mungon energjia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyen pasiviteti ose aktiviteti i ulët më funksionimin ditor të fëmijës?

Jo Pak Goxha Shume

Planifikimi/organizimi; aftësia e fëmijës për të planifikuar ose organizuar aktivitete

40. Vështirësi për të kuptuar pasojat e veprimeve të veta, nuk kupton se çfarë mund të ndodhë (p.sh., ngjitet në vende të rrezikshme, i pakujdesshëm në trafik)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
41. Vështirësi në planifikim dhe përgatitjen e një aktiviteti (p.sh., grumbullimi i pajisjeve të nevojshme për një ekskurzion/shëtitje ose për shkollë)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
42. Vështirësi për të përfunduar detyra me sekuenca (p.sh., fëmijët e vegjël: veshja në mëngjes pa përkujtime të vazhdueshme; fëmijët e rritur: kryerja e detyrave të shtëpisë pa përkujtime të vazhdueshme)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyjnë problemet më planifikim/organizim në funksionimin ditor të fëmijës?

Jo Pak Goxha Shume

Përceptimi i hapësirës dhe drejtimeve; përceptimi i hapësirës dhe drejtimeve nga fëmija në botën fizike:

- | | | | |
|---|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 43. Vështirësi për të gjetur rrugën përreth (edhe në vendet e njohura mirë) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 44. Ështrë i i/e pasigurtë nga ndryshimet në lartësi (madje edhe më të voglat) si për shembull gjatë ngjitjes së shkallëve mbahet tek muri/parmaku etj. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 45. Ka vështirësi për të gjykuar distancën ose madhësinë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 46. Ka vështirësi për të kuptuar orientimin dhe udhëzimet hapësinore (fëmijët e vegjël i kthejnë rrobat mbrapsh, fëmijët më të mëdhenjë ngatërrojnë shkronjat si b, p, d, ose shifra si 6, 9) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 47. Godet padashje gjatë takimit njerëzit e tjerë, veçanërisht në vende të ngushta | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Perceptimi dhe konceptet e kohës; aftësia e fëmijës për të kuptuar konceptet e kohës:

- | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 48. Konceptim i dobët i kohës, p.sh., nuk ka një ndjenjë intuitive se sa zgjasin "pesë minuta" ose "një orë" ose është i/e pasigurt për sa kohë më parë ka ndodhur diçka | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 49. Ka ide jo të qartë se sa është ora, nëse është mëngjes apo pasdite, nëse është apo nuk është koha të shkojë në shkollë - nëse është ditë jave apo fundjave | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 50. Pyet në mënyrë të përsëritur se kur do të ndodhë diçka, p.sh., sa kohë ka mbetur para një shëtitjeje ose para kohës për të shkuar në shkollë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 51. Mund ta lexojë orën mekanikisht, por nuk e kupton konceptin aktual të kohës | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Perceptimi i trupit të vet; perceptimi i fëmijës për trupin e tij/saj dhe ndijimet shqisore:

- | | | | |
|---|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 52. Nuk ka një ndjenjë se si të veshë në mënyrë të duhur rrobat, nuk i drejton çorapet ose pantallonat që kanë rrëshqitur | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 53. Çuditshëm nuk reagon ndaj të ftohtit, dhimbjes etj. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 54. Vetëdije e dobët i trupit (pasiguri për madhësinë e trupit të vet në raport me mjedisin, p.sh., përplasjet me gjërat pa qëllim) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 55. Ndjeshmëri të madhe ndaj prekjës (irritohet nga rrobat e ngushta, percepton prekjën e butë sikurse të jetë e ashpër etj) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 56. Vështirësi për të imituar lëvizjet e njerëzve të tjerë, si përshembull në aktivitetet sportive ose gjatë këndimit/vallëzimit | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

Perceptimi i formave dhe figurave vizuale; aftësia e fëmijës për të perceptuar forma dhe figura:

- | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| 57. Ka tendencë për të keqinterpretuar fotografitë; pra kupton diçka tjetër nga ajo çka sheh p.sh., mund të perceptojë një fotografi të një veze të skuqur si të jetë e një luleje | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 58. Vështirësi për të vërejtur dallime në forma, figura, fjalë dhe modele që duken ngjashëm | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 59. Vështirësi për të vizatuar nga imagjinata, një makinë, një shtëpi etj. (në krahasim me fëmijët e gjeneratës) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| 60. Vështirësi për të bashkuar figura/enigma ("pazëlls") | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

A ndërhyjnë në funksionimin ditor të fëmijës tuaj problemet me perceptimin e hapësirës dhe drejtimeve, kohës, trupit të tij ose format dhe figurat?

Jo Pak Goxha Shume

Kujtesa; aftësia e fëmijës për të kujtuar fakte ose gjërat që ai/ajo ka përjetuar

61. Vështirësi për të mbajtur mend të dhëna personale, të tilla si data e lindjes, adresa e shtëpisë etj	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
62. Vështirësi për të mbajtur në mend emrat e njerëzve të tjerë të rrethit (p.sh., emrin e mësimshënësit, moshatarët e shkollës)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
63. Vështirësi për të mbajtur në mend emrat e ditëve të javës, muajve dhe stinëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
64. Vështirësi për të mbajtur mend fakte jo personale të mësuara në shkollë (p.sh., ngjarje historike, formula kimike etj)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
65. Vështirësi për të mbajtur në mend i çka ka ndodhur kohët e fundit, si kush ka telefonuar ose, çfarë ka ngrënë disa orë më parë etj	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
66. Vështirësi për të kujtuar ngjarje që kanë ndodhur disa kohë më parë, të tilla si çfarë ndodhi në një udhëtim, çfarë dhuratë ka marrë për Krishtlindje/Vit të Ri, etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
67. Vështirësi për të mbajtur në mend se ku ai/ajo vendos gjërat	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
68. Vështirësi për të kujtuar takimet me bashkëmoshatarë ose çfarë detyrë shtëpie ai/ajo ka	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
69. Vështirësi për të mësuar përmendësh rima, këngë, tabelën e shumëzimit etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
70. Vështirësi për të mbajtur në mend udhëzime të gjata ose me shumë hapa	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
71. Vështirësi për të fituar aftësi të reja, si mësimi i rregullave të një loje të re	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyjnë problemet me kujtesë në funksionin ditor të fëmijës tuaj?

Jo Pak Goxha Shume

Kuptimi i gjuhës së folur; aftësia e fëmijës për të kuptuar gjuhën dhe të folurit:

72. Vështirësi për të kuptuar shpjegimet dhe udhëzimet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
73. Vështirësi në ndjekjen e tregimeve të lexuara me zë të lartë kur dikush lexon një tregim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
74. Vështirësi për të kuptuar atë që thonë njerëzit e tjerë (shpesh thotë "çfarë?", "çfarë doni të thoni?")	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
75. Vështirësi me koncepte abstrakte të tilla si "pasnesër", "një mendje e shëndoshë"	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
76. Ka tendencë të keqinterpretojë atë që thuhet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Gjuha shprehëse; aftësia e fëmijës për të shprehur gjuhën dhe për të shqiptuar fjalët:

77. Pasiguri në tingujtë e të folurit dhe ka tendencë të keqartikulojë fjalët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
78. Vështirësi për të mësuar emrat e ngjyrave, njerëzve, shkronjave etj	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
79. Vështirësi për të gjetur fjalë ose për t'u shpjeguar njerëzve të tjerë, thotë: "ëë, ëë, ëë ..."	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
80. Ka tendencë të kujtojë fjalët gabimisht, thotë "hark i krahut" në vend të "bërryl", i referohet "treguesit" në vend të "akrepit të orës" etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
81. Vështirësi për të shpjeguar atë që ai/ajo dëshiron	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
82. Vështirësi në të folurit e rrjedhshëm pa asnjë ndërprerje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
83. Vështirësi për të shprehur veten në fjali të plota, me saktësi gramatikore ose në lakimin e fjalëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	Nuk aplikohet	Deri në një masë aplikohet	Aplikohet
84. Shqipton tinguj specifikë në mënyrë të gabuar (ka thuthuqësi – flet me “th”, vështirësi në shqiptimin e tingullit të “r”, ka “zë të hundës” etj.)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
85. Vështirësi në shqiptimin e fjalëve komplekse si "elektrike", "kaçavidë" etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
86. Ka zë të ngjirur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
87. Belbëzon	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
88. Flet aq shpejt sa është e vështirë të kuptosh atë që ai/ajo po thotë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
89. Ka një të folur të ngatërruar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komunikimi verbal; aftësia e fëmijës për të përdorur gjuhën dhe aftësia për të komunikuar me të tjerët:

90. Vështirësi për të treguar përvojat ose situatat në mënyrë që dëgjuesi të kuptojë (p.sh. çfarë ndodhi gjatë ditës ose gjatë pushimeve verore)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
91. Vështirësi për të qëndruar “në linjë të duhur” kur tregon diçka	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
92. Vështirësi për të marrë pjesë në një bisedë, p.sh., probleme për të kaluar nga të dëgjuarit në të folur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyt në funksionin e përditshëm të fëmijës tuaj problemet me të kuptuarit e gjuhës, përdorimin e gjuhës ose komunikimin verbal?

Jo Pak Goxha Shume

Përvetësimi i aftësive akademike; nëse fëmija është nën 8 vjeç, kaloni në deklaratën I 22

Pyetjet në lidhje me të mësuarit e fëmijëve mund të jenë të vështira për prindërit pa informacion nga mësuesi/ja i fëmijës. Sidoqoftë, ju lutemi përpiquni t'i përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme bazuar në atë që dini ose në atë që keni dëgjuar nga mësuesi/ja i fëmijës.

Lexim, shkrim, matematikë (vetëm fëmijë 8 vjeç e lart):

93. Përvetësimi i aftësive për të lexuar është më i vështirë sesa pritej duke marrë parasysh aftësinë e tij/saj për të mësuar gjëra të tjera	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
94. Ka vështirësi për të kuptuar atë që ai/ajo po lexon	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
95. Vështirësi për të lexuar me zë të lartë me shpejtësi normale (lexon shumë ngadalë, shumë shpejtë ose nuk lexon rrjedhshëm)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
96. Nuk e pëlqen leximin (p.sh., shmang leximin e librave)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
97. Hamendëson gjatë leximit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
98. Vështirësi në shqiptimin shkronjë-më-shkronjë të fjalëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
99. Ka vështirësi në formësimin e shkronjave dhe për të shkruar pastër	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
100. Vështirësi në formulimin e vetes së tij/saj në shkrim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
101. Vështirësi në përvetësimin e aftësive themelore të matematikës (mbledhja, zbritja; d.m.th., plus, minus)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
102. Vështirësi me detyrat e matematikës të dhëna në formë të shkruar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
103. Vështirësi për të mësuar dhe zbatuar rregulla të ndryshme matematikore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
104. Vështirësi për të mësuar dhe përdorur tabelat e shumëzimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
105. Vështirësi me aritmetikën (kalkulimet) mendore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Të mësuarit e gjërave të reja dhe zbatimi i njohurive në shkollë (vetëm fëmijë 8 vjeç e lart):

106. Vështirësi për të kuptuar udhëzimet verbale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
107. Vështirësi për të kuptuar ose përdorur terma abstrakt, p.sh., terma që kanë të bëjnë me madhësinë, vëllimin, drejtimet hapësinore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
108. Vështirësi për të marrë pjesë në diskutime me fëmijë të tjerë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
109. Vështirësi për të mësuar fakte ose përvetësuar njohuri për botën përreth	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
110. Njohuri ose aftësi të jashtëzakonshme në disa fusha	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
111. Është i/e mirë në gjërat artistike ose praktike (për të luajtur një instrument, vizatim, pikturë, punëdore)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Zgjidhja e problemeve në shkollë dhe qasja ndaj situatave të reja të të mësuarit (vetëm fëmijë 8 vjeç e lart):

112. Vështirësi në planifikimin dhe organizimin gjatë të mësuarit, (p.sh., renditja sipas së cilës duhet të bëhen gjërat, sa kohë nevojitet për të menaxhuar një detyrë specifike)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
113. Vështirësi e ndryshimit të planit ose strategjisë kur kjo kërkohet dhe mënyra e punës duhet ndryshuar (p.sh., kur qasja fillestare dështon)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
114. Vështirësi për të kuptuar shpjegimet dhe për të ndjekur udhëzimet e dhëna nga të rriturit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
115. Vështirësi në zgjidhjen e detyrave abstrakte (d.m.th., varet nga materiali mësimor që mund të shihet ose preket)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
116. Vështirësi për të vazhduar përpjekjen dhe përmbushjen e detyrave, shpesh i lë ato gjysmë të përfunduara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
117. I/e pamotivuar për punë në shkollë ose për situata të krahasueshme të të mësuarit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
118. Të mësuarit është i ngadaltë dhe i mundimshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
119. Bën gjërat shumë shpejt, me ngut ose me nxitim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
120. Nuk dëshiron/nuk mund të marrë përgjegjësi për veprimet e veta, ka nevojë për shumë mbikëqyrje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
121. Ka nevojë për shumë mbështetje, dëshiron të dijë nëse ai/ajo po performon mirë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Problemet akademike ose vështirësitë e të mësuarit ndërhyjnë në funksionin e përditshëm të fëmijës tuaj?

Jo Pak Goxha Shume

Aftësitë sociale; the child's capacity to participate in social settings and interact with others

122. Nuk i kupton shenjat shoqërore të njerëzve të tjerë, p.sh., shprehjet e fytyrës, gjestet, tonin e zërit ose gjuhën e trupit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
123. Vështirësi për të kuptuar dhe për të treguar ndjeshmëri për ndjenjat e njerëzve të tjerë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
124. Vështirësi të veprojë në plotësimin e nevojave të njerëzve të tjerë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
125. Vështirësi në shpjegimin verbal të emocioneve si psh. kur ndjehen të vetmuar, të mërzitur etj	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
126. Flet me një zë monoton ose të çuditshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	Nuk aplikohet	Deri në një masë aplikohet	Aplikohet
127. Vështirësi për të shprehur emocione dhe reagime me gjeeste të fytyrës ose me gjuhën e trupit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
128. Dukshëm sillet dhe flet si një person i rritur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
129. Vështirësi për t'u sillur siç pritet nga bashkëmoshatarët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
130. Vështirësi për të kuptuar sesi të sillet në situata të ndryshme shoqërore, të tilla si kur viziton të afërmit së bashku me prindërit, kur viziton miqtë, viziton një mjek, shkon në kinema, etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
131. Perceptohet nga bashkëmoshatarët si i ndryshëm, i çuditshëm ose jokonvencional (jo i zakonshëm).	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
132. Pa qëllim bën gjeeste të cilat e bëjnë të duket si budalla, gjë që i bën prindërit të ndjehen të turpëruar ose bashkëmoshatarët fillojnë të qeshin	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
133. Shpesh i mungon sensi/logjika	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
134. Ka një sens të dobët humori	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
135. Bën komente që janë shoqërisht të papërshtatshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
136. Vështirësi për të kuptuar urdhërat dhe ndalesat	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
137. Shpesh grindet me bashkëmoshatarët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
138. Vështirësi për të kuptuar dhe respektuar të drejtat e njerëzve të tjerë, për shembull, që fëmijët më të vegjël kanë nevojë për më shumë ndihmë sesa ata më të mëdhenjtë dhe që prindërit duhet të lihen vetëm kur e kërkojnë atë, etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
139. Vështirësi në aktivitetet ose lojërat në grup ose ekip, shpik rregulla rreth lojes nga vetvetja te cilat per femijet e tjere nuk jane objektive	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
140. Vështirësi për të bërë miq	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
141. Nuk ndërvepron shpesh me bashkëmoshatarët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
142. Vështirësi për të marrë pjesë në aktivitetet dhe lojërat në grup	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
143. Nuk pranohet nga fëmijët e tjerë për të marrë pjesë në lojërat e tyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
144. Nuk shpreh interesim për kontakt fizik siç janë përqaftimet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
145. Ka një ose disa interesa që marrin shumë kohë dhe që çenojnë marrëdhëniet me familjen dhe miqtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
146. Përsërit ose ngec në sjelljet ose aktivitetet në dukje të pakuptimta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
147. Shqetësohet shumë nga ndryshimet e vogla në rutinat ditore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
148. Kontakti me sy në situata ballë për ballë është jo-normal ose mungon	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyjnë problemet me aftësitë shoqërore në funksionin e përditshëm të fëmijës tuaj?

Jo Pak Goxha Shume

Problemet emocionale:

149. Ka vetëbesim të ulët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
150. Duket të jetë i/e pakënaqur, i/e pikëlluar, i/e dëshpëruar (depresionuar)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
151. Shpesh ankohet për ndjenjat e vetmisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
152. Është përpjekur të lëndo vetvehten ose flet për këtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
153. Ka oreks/apetit të dobët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
154. Shpesh shpreh një ndjenjë të të qenit i/e pavlefshëm ose inferior/e ndaj fëmijëve të tjerë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

	Nuk aplikohet	Deri në një masë aplikohet	Aplikohet
155. Shpesh ankohet për dhimbje barku, dhimbje koke, vështirësi në frymëmarrje ose simptoma të tjera trupore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
156. Duket i/e tensionuar dhe i/e shqetësuar ose ankohet se është në siklet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
157. Bëhet shumë i/e shqetësuar ose i/e pakënaqur kur largohet nga shtëpia p.sh., kur shkon në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
158. Ka më shumë probleme me gjumin sesa shumica e fëmijëve në moshë të ngjashme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
159. Shpesh ka makthe të natës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
160. Ecën në gjumë ose ka sulme nate kur ai/ajo nuk mund të "arrihet (kthjellet)" ose të qetësohet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
161. Shpesh humbet gjakftohtësinë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
162. Shpesh grindet/zihet me të rriturit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
163. Shpesh refuzon të ndjekë udhëzimet e të rriturve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
164. Shpesh ngacmon të tjerët duke bërë qëllimisht gjëra që perceptohen si provokuese	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
165. Shpesh fajëson të tjerët për gabimet e veta ose veprimet e këqija	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
166. Ofendohet lehtë, ose lëndohet nga të tjerët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
167. Shpesh futet në përleshje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
168. Është mizor/e me kafshët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
169. Gënjen dhe mashtron	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
170. Vjedh gjëra në shtëpi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
171. Shpesh shkatërron sendet e anëtarëve të tjerë të familjes ose fëmijëve të tjerë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
172. Ka episode të përsëritura disa ditore me nivel jashtëzakonisht të lartë të aktivitetit, dhe fluturime idesh	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
173. Ka periudha të përsëritura të irritimit të dukshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Mendime ose veprime obsesive; mendimet ose veprimet që ai/ajo duket se nuk është në gjendje të kontrollojë

174. Përsërit kompulsivisht disa aktivitete ose ka zakone që janë shumë të vështira të ndryshohen	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
175. Ka ide fikse/obsesive	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
176. Ka lëvizje të pavullnetshme, tike, lëvizje dridhëse ose grimase në fytyrë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
177. Përsërit lëvizje të pakuptimta, të tilla si tundja e kokës, tundja e trupit dhe trokitje me gishta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
178. Lëshon tinguj të pavullnetshëm siç janë pastrimi i fytyrës, teshtitja, gëlltitja, lehja, të bërtitura e papritura etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
179. Vështirësi për të mbajtur qetësinë p.sh., fishkëllon, gumëzhit, murmurit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
180. Përsërit fjalë ose pjesë të fjalëve në një mënyrë të pakuptimtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
181. Përdor fjalë të pista apo gjuhë të ndytë në një mënyrë të ekzagjeruar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

A ndërhyjnë në funksionin e përditshëm të fëmijës tuaj problemet emocionale, veprimet obsesive ose mendimet?

Jo Pak Goxha Shume

Përshkruani problemet e fëmijës tuaj për të cilat shqetësoheni më së shumti:

Përshkruani pikat e forta të fëmijës suaj:
